



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2019:267468  
Datë: 31.03.2023  
Numri i dokumentit: 04143392

ARJ nr.10/2023

Gjykata Supreme në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Fejzulah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, Komuna e Prishtinës, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,(MMPH), me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit, duke vendosur sipas kërkesës së paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar për mes të autorizuarit, Shoqëria e Avokatëve Sejdiu&Qerkini, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA nr.760/2022 të datës 08.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09 Mars 2023, merr;

**A K T G J Y K I M**

I. Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësja Komuna e Prishtinës, kundër Aktvendimit i Gjykatës së Apelit Departamenti për Çështje Administrative AA nr. 760/2022 i datës 08.11.2022.

II. Anulohen, aktvendimi i Gjykatës së Apelit Departamenti për Çështje Administrative AA nr.760/2022 i datës 08.11.2022, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.2092/2019 i datës 09.09.2022. Lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA nr. 760/22 të datës 08.11.2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses Komuna e Prishtinës e datës 10.10.2022, ndërsa aktvendimi Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A nr.

2092/2019 i datës 09.09.2022, vërtetohet, me të cilin hedhet poshtë si e pa lejuar padia e paditëses Komuna e Prishtinës , e ushtruar kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë nën shenjën, A nr. 2092/19.

Paditësi Komuna e Prishtinës për mes përfaqësuesit së më lartë në afat ligjor parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurale nga neni 24.2 të LKA, të cilat kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes me propozim, të aprovohet në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paditësit, ndërsa të anulohen Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AA nr. 760/22 i dt. 08.11.2022, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore, A nr. 2092/19, i dt.09.09.2022, dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme , në bazë të nenit 53 të Ligjit për konflikte administrative , ka mbajtur seancë dhe pas vlerësimit të aktvendimeve të goditura sipas pretendimeve në kërkesë dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura MMPH, me vendimin e saj A-81/19 të dt. 08.08.2019, e aprovon si të bazuar ankesën e “MCM C. C.r”, sh.p.k., me seli në P.. E shfuqizon Vendimin 05 nr.353/04-0268252/18 të dt. 20.02.2019, të Drejtorisë për Urbanizëm, Komuna Prishtinë dhe e detyron Drejtorinë e njëjtë të veproj sipas kërkesës së palës dhe Vendimit për Uniformimin e Shkallëve dhe Panove Reklamuese për Komunën Prishtinë.

Paditësja Komuna e Prishtinës e pa kënaqur me vendimin e lartë cekur të paditurës MMPH, ushtron padi në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, nr. A-81/19, të dt. 08.08.2019, me kërkesë padi që i njëjti të anulohet si jo i drejtë dhe i pa bazuar në ligj.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me datë 09.09.2022, jashtë seance merr Aktvendimin A. nr.2092/19, me të cilin hedhet poshtë si e pa lejuar, padia e paditëses Komuna e Prishtinës e ushtruar kundër të paditurës MMPH, me shenjën A nr. 2092/19.

Gjykata e Apelit duke vendosur në procedurë ankimore, me aktvendimin, AA 760/2022, të dt. 08.11.2022, e refuzon si e pa bazuar ankesën e dt. 10.10.2022, të paditëses, ndërsa aktvendimin e të gjykatës së shkallës së parë, A nr. 2092/19 të dt. 09.09.2022, e vërteton. Në arsyetim, pasi e përshkruan mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë dhe arsyetimin e vendimit të saj, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e vlerëson të drejtë dhe ligjor nga se edhe kjo gjykatë vlerëson se në këtë çështje nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të filluar procedura e shqyrtimit të çështjes në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ sipas nenit 15.1.2 të LKA, i cili rregullon rastet kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, dhe pasi e citon të njëjtin konstaton se, paditësi me padi nuk e konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, kundër të cilit ka mundur të hapet konflikti administrativ për tu vlerësuar ligjshmëria e tij ashtu si parashihet në nenin 9 të LKA. Pretendimet e paditësit

në ankesë i refuzon si jo të bazuara dhe vlerëson se shkalla e parë ka vendosur drejtë me hedhjen poshtë të padisë si në vështrim të nenit 34, par.1,pika 5, të LKA si e palejueshme.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes vlerëson, se tani për tani nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe ligjor qëndrimi juridik i Gjykatës së Apelit por as i gjykatës së shkallës së parë si në aktvendimet e tyre, andaj kolegji Gjykatë Supreme vlerëson se aktvendimi i kontestuar me kërkesë është i përsirë me shkelje thelbësore nga neni 182 par. 2 pika n), dhe neni 194, të LPK-së, sepse gabimisht i ka vërtetuar faktet vendimtare, sipas çështjes në shqyrtimi përkatësisht vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit përfundimtar të MMPH i nxjerrë në procedurë administrative sipas gjendjes së fakteve dhe dispozitave të nenit 9, 10. Par. 1 dhe 3, neni 15, par. 1. 2. dhe nenit 34, të LKA-së, me hedhjen poshtë të padisë si të parakohshme, duke i aplikuar në mënyrë jo të drejtë këto dispozita ligjore të LKA-së.

*Sipas nenit 9 të LKA , përcaktohet citim, “Gjykata në konflikt administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin për të drejtat detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative” .*

*Sipas nenit 10.1, të LKA, përcaktohet se, citim”, të drejtë për të nisur konflikt administrativ ka çdo person fizik apo juridik nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtarë në procedurë administrative i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes Ligjor”.*

*Sipas nenit 10.3 të LKA, përcaktohet, citim” organi ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ ,kundër vendimit që është marrë në bazë të ankesës , në procedurën administrative ,nëse ajo/ai konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij”.*

*Sipas nenit 13 parag.1, përcaktohet, citim,” konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ i nxjerrë në procedurë administrative të shkallës së dytë”.*

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme bazuar në dispozitat e cekura si më lartë të LKA, vendimi i të paditurit i MMPH, A nr. A-81/19, i dt. 08.08.2019, është akt përfundimtar i shkallës së dytë, si parashihet në nenin 13.1, të LKA, me të cilin organi administrativ përfundimtar-i padituri në kuadër të autorizimeve të tija ligjore gjatë ushtrimit të autorizimeve publike ka vendosur për të drejta, detyrime dhe interesa juridike të personave fizik dhe juridik në çështjen konkrete administrative. E paditura MMPH, duke vendosur sipas ankesës së palës ankuese, me vendimin e kontestuar me padi e shfuqizon vendimin 05 nr.353/04-0268252/18, të dt. 20.02.2019, të Drejtorisë për Urbanizëm ,Komuna e Prishtinës, dhe këtë Drejtori, si në pikën III., të dispozitivit të vendimit e detyron të veprojnë sipas kërkesës së palës dhe Vendimit për Uniformimin e shkallëve dhe Panove Reklamuese për Komunën Prishtinë. Pra me këtë mënyrë të vendosjes janë krijuar detyrime për paditësen e cila ka vendosur në shkallë të parë si person juridik-njësi themelore e qeverisjes lokale. Prandaj Gjykata Supreme vlerëson se me që vendimi i MMPH është përfundimtar në procedurë administrative i nxjerrë sipas ankesës, ndaj tij pala ka të drejtë të filloj konflikt administrativ dhe si në kuptim të nenit 9, gjykata detyrohet të vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur me të cilin MMPH si organ tjetër dhe më i lartë, sipas kompetencës ligjore, me shfuqizimin e vendimit të shkallës së parë ka krijuar obligime për palën tjetër që të veprojnë dhe vendos sipas kërkesës së palës kërkuese. Në këtë çështje me që janë

shtjerrë mjetet juridike në procedurën administrative, paditësi ka të drejtë të ushtroj padi dhe për mes saj të mbroj qëndrimet si në vendimin e saj, përkatësisht të kontestoj vendimin me të cilin është shfuqizuar akti i saj dhe i janë caktuar obligime konkrete.

Në kuptim të nenit 10, parag. 1, 2, dhe 3, të LKA, të drejtë për të nisur konflikt administrativ ka personi fizik apo juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar i nxjerrë sipas ankesës në procedurë administrative, i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes ligjor, si në këtë rast që me anulimin e vendimit të paditëses nga organi më i lartë kompetent për vendosje sipas ankesës, paditësja konsideron se është cenuar ligji- e drejta materiale dhe kërkon nga gjykata duke bërë vlerësimin e ligjshmërisë së tij të njëjtin ta anuloj si jo të drejtë dhe ligjor.

Gjykata Supreme bazuar në nenin 15, parag.1, dhe 2, të LKA, nuk gjen prova se aktin e atakuar me padi pala ka mundur ta kontestoj në procedurë tjetër gjyqësore, apo që sipas ligjit parashihet se kundër këtij lloji të vendimeve nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ (si parashihet në parag. 2, të këtij neni), ashtu si e theksojnë gjykatat e instancave më të ulëta në vendimet e tyre, sepse ndaj këtij vendimi nuk dëshmohet se është e siguruar mbrojtje tjetër gjyqësore si parashihet me këtë nen.

Baza ligjore përkatësisht neni 34, parag. 1, pika 5, në të cilën bazohen vendimet e gjykatave të instancës më të ulëta me hedhjen e padisë si të pa lejueshme sipas së cilës parashihet se, *“është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”*, nuk është e qëndrueshme, sepse sipas kësaj dispozite të cituar, por edhe nga paragrafët tjerë të këtij neni, nuk është krijuar asnjë rrethanë për hedhjen e padisë, pra nuk parashihet që një vendim i nxjerrë sipas ankesës në procedurë administrative që ndaj tij nuk mund të filloj konflikti administrativ.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate duhet të potencohet edhe fakti se edhe i padituri me që ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative, në këshillë juridike e parashih të drejtën që pala e pa kënaqur ka të drejtë me padi të incizoj procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi. Prandaj nuk janë të qëndrueshme arsyet e paraqitura nga gjykata e shkallës së dytë e cila pretendimet e paditësit në këtë drejtim i refuzon, sipas arsyeve se, *“paditësja në asnjë fazë nuk ofron dëshmi se ka vepruar në baza ligjore sipas dispozitave të LKA për fillimin e procedurës gjyqësore, përkatësisht se i ka shtjerrë mjetet juridike ashtu si parashihet sipas LPPA-së në procedurë administrative”*, sepse sipas nenit 9 të LKA nuk parashihet ky konstatim i cekur nga gjykatat e instancave më të ulëta, gjer sa akti-vendimi i MMPH është përfundimtar i nxjerrë në procedurë administrative si kuptim të nenit, 126, parag. 1, dhe 6, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas së cilit përcaktohet se, *“shërimi i mjetit juridik të rregullt në procedurë administrative është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështje administrative”*.

Nga theksimet si më lartë me që aktvendimet e kontestuar janë të përfshirë me shkeljet e pretenduara si në kërkesë dhe si në kuptim të dispozitave të cekura si më lartë të LKA-së, të njëjtit anulohen dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së parë obligohet që në ri procedurë ti mënjanoj mangësitë e cekura ti shqyrtoj dhe vlerësoj provat dhe faktet e paraqitura me padi, ankesë dhe kërkesë për rishqyrtim

të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe pas administrimit të provave të merr vendim të drejtë dhe ligjor duke e vendosur në mënyrë meritore çështjen sipas padisë së paditësit. Gjykatat e instancave më të ulëta në ri procedurë duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë të gjeturave dhe vërejtjeve të theksuara si më lartë në këtë aktgjykim.

Nga theksimet si më lart, dhe në pajtim me nenin 54, paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME –PRISHTINË**

ARJ nr. 10/2023, me datë, 09 Mars 2023.

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani